

Ajet kuranor

Allahu i Madhërishëm thotë:

????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ?????? ???
????????? ?????? ??????????????????????

"Ata që u përmbahen thënieve të Librit dhe që e kryejnë namazin, ta dinë se Ne, pa dyshim, nuk do t'ua humbim shpërblimin punëmirëve." (Kurani, 7:170)

Thënie profetike

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ?, ka thënë:

"Pesë namazet ditore, prej njërit deri te tjetri, namazi i xhumasë, prej njërit deri te tjetri, dhe Ramazani, prej njërit deri në Ramazanin tjetër, shlyejnë gjynahet që janë në mes tyre, nëse ruheni prej mëkateve të mëdha."

[E shënon Muslimi.]

Urtësi

Ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, thoshte: *"Ai që fal namaz, troket në derën e Mbretit (Allahut) dhe, kujtdo që vazhdon së trokituri në atë derë, një ditë do t'i hapet."*

Nuk mund të falem, sepse s'mund të heq dorë nga gjynahet (!)

Për asnjë arsye mos e lër namazin! Falu, edhe në qofsh mëkatari më i madh! Nëse e fal namazin, Allahu do të të ndihmojë të bëhesh besimtar i denjë dhe të largohesh nga punët e këqija.

Këshillë

Asnjëherë mos e lër namazin javor, atë të xhumasë, por fale, që ta fitosh mëshirën dhe kënaqësinë e Zotit tënd Bujar!

Përgatiti: Hoxhë Jusuf Kastrati